



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 35

Tiranë – E hënë, 26 tetor 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Urdhër i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës nr. 2363, datë 21.10.2020	Për delegim kompetence..... 3
Njoftim i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 6901, datë 23.10.2020	Për shpalljen e një vendi vakant për pozicionin e Këshilltarit Ekonomik dhe të dy vendeve vakante për pozicionin e Këshilltarit Ligjor..... 3

**URDHËR**

Nr. 2363, datë 21.10.2020

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 28, germa “d”, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, dhe të nenit 9, të ligjit 111/2020, “Për kadastrën”, në funksion të mbarëvajtjes të veprimtarisë administrative dhe të zbatimit të detyrimeve të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi, për shkak të paaftësisë së përkohshme në punë të drejtorit të përgjithshëm të ASHK-së,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të drejtorit të përgjithshëm të drejtorit i Njësisë Juridike dhe Kontrollit, znj. Jeta Velaj, nga data 21.10.2020 deri në përfundim të paaftësisë së përkohshme, për nënshkrimin e autorizimeve mbi të drejtën e përfaqësimit, deklaratave të mbrojtjes, prapësimeve, ankimeve, ankimeve të veçanta, rekurseve, kërkesave për pezullim, si dhe çdo akti tjetër procedural në funksion të mbrojtjes efektive të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës në proceset gjyqësore.

2. Ngarkohen njësitë në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së dhe znj. Jeta Velaj për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Artan Lame

NJOFTIM

Nr. 6901, datë 23.10.2020

**PËR SHPALLJEN E NJË VENDI
VAKANT PËR POZICIONIN E
KËSHILLTARIT EKONOMIK DHE TË
DY VENDEVE VAKANTE PËR
POZICIONIN E KËSHILLTARIT LIGJOR****Këshilltar Ekonomik**

Në zbatim të nenit 22, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall fillimin e procedurave për personat e interesuar, që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin e Këshilltarit Ekonomik në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, kategoria e pagës: 80% e G3.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

a) Të kenë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare në shkenca ekonomike, matematikë ose në drejtësi me diplomë “master i shkencave” në Shqipëri ose studimet universitare për shkenca ekonomike, matematikë ose në drejtësi jashtë vendit dhe të jetë e njësuar sipas legjislacionit në fuqi për njësimin e diplomave.

b) Të zotërojnë shumë mirë gjuhën angleze.

c) Të kenë shtatë vjet përvojë pune në sektorin financiar.

Kushte të përgjithshme:

- Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret për t’u pajisur me certifikatë sigurie, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.

- Ndaj tyre të mos jetë nisur procedim penal, të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtjeje penale.

- Ndaj tyre të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit.

- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t’u përshtatur e për të punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim, shprehje interesi;



2. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare.

3. Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftim, librezë pune (origjinale ose të noterizuar)).

4. Dëshmi penaliteti.

5. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.

6. Çdo dokumentacion tjetër, që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe në trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda datës 4.11.2020, pranë institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në adresën: Rruga e Kavajës, ish- Lidhja e Shkrimtarëve, Tiranë, Zyra e Protokollit, nga e hëna—të premten, ora 08:30–17:00, ose nëpërmjet postës elektronike, në adresën: info@kpk.al, i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Këshilltar Ligjor

Në zbatim të nenit 22, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit shpall fillimin e procedurave për personat e interesuar, që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin e Këshilltarit Ligjor në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, kategoria e pagës: 80% e G3.

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

a) Të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë “master i shkencave” në Shqipëri ose studimet universitare për drejtësi jashtë vendit dhe ka marrë diplomë të njësuar sipas legjislacionit në fuqi për njësimin e diplomave.

b) Të zotërojë shumë mirë gjuhën angleze.

c) Të ketë shtatë vjet përvojë pune në sistemin e drejtësisë ose në administratën publike.

Kushte të përgjithshme:

- Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret për t’u pajisur me certifikatë sigurie sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.

- Ndaj tij të mos jetë nisur procedim penal, të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtjeje penale.

- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit.

- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t’u përshtatur e për të punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Kandidati i interesuar duhet të dorëzojë dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim, shprehje interesi;

2. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare.

3. Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftim, librezë pune (origjinale ose të noterizuar)).

4 Dëshmi penaliteti.

5. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.

6. Çdo dokumentacion tjetër, që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe në trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda datës 4.11.2020, pranë institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në adresën: Rruga e Kavajës, ish-Lidhja e Shkrimtarëve, Tiranë, Zyra e Protokollit, nga e hëna—të premten, ora 08:30–17:00, ose nëpërmjet postës elektronike, në adresën: info@kpk.al, i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Tiranë, 2020